

STATUTI I
GRUPIT LOKAL TË VEPRIMIT - AGRO-TURIZMI



STATUTI I GRUPIT LOKAL TË VEPRIMIT “AGRO-TURIZMI” PEJË

Statuti i Grupit Lokal të Veprimit “AGRO-TURIZMI” Pejë

Ky Statut do të qeverisë Shoqatën jo-profitabile Grupi Lokal i Veprimit “Agro-Turizmi” Pejë, të themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-134 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1 - Emri, forma dhe adresa

- 1.1 Organizata do të quhet Grupi Lokal i Veprimit “Agro-Turizmi” Pejë
- 1.2 Ajo mund të njihet edhe si GLV “Agro-Turizmi” Pejë
- 1.3 Organizata është shoqatë jo-profitabile, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 03/L-134 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
- 1.4 Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet joprofitabile të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte për asnjë nga themeluesit, drejtorin, nëpunësin, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona kanë bërë për këtë organizatë.
- 1.5 Ndonjë transakcion në mes të anëtarëve, anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, personi ose nëpunësi dhe organizatës duhet të mbyllet në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.
- 1.6 Organizata e ka zyren e saj qendrore në Ndertesën e Kuvendit Komunal Drejtoria e Bujqësisë të KK Pejë.

Neni 2 – Themeluesit

- 2.1 Themelues të organizatës janë:
 1. Mehdi Mulaj, fshati Llozhan KK Pejë,
 2. Sabahate Qorkadiu, adresa rr. Ramiz Xhema nr. 3 Pejë
 3. Pakize Kastrati, adresa Fusha e Pejës, rr. Ali Husvukaj nr. 40, Pejë.
- 2.2 Përfaqësues i autorizuar i organizatës në Kosovë është Mehdi Mulaj fshati Llozhan KK Pejë
- 2.3 Përfaqësuesi i autorizuar emërohet nga Bordi i Drejtorëve dhe duhet të përfaqësojë organizatën në Kosovë dhe pranojë të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai ose ajo duhet të jetë përgjegjës për informimin e autoriteteve relevante administrative për çfarëdo ndryshimi në organizatë.

STATUTI I GRUPIT LOKAL TË VEPRIMIT "AGRO-TURIZMI" PEJË

Neni 3 - Qëllimi

3.1 Organizata është themeluar me qëllim të:

Bashkojë organizatat ekzistuese publike dhe private të përcaktuara në komunën e Pejës për të promovuar zhvillimin e ekonomisë lokale, për të shtuar të ardhurat për individët dhe ndërmarrjet, shtuar punësimin në nivelin lokal, mbrojtur dhe shtuar vlerën trashëgimisë lokale natyrore dhe kulturore dhe për të ndërmarrë dhe mbështetur çfarëdo veprimi tjetër i cili synon menaxhim më të mirë të viseve rurale brenda territorit të komunës së Pejës.

Objektivat specifike të GLV-së – Agro-Turizmi do të jenë për të:

1. Stimuluar nismat kreative publike dhe private në fushën e zhvillimit rural në territorin e komunës së Pejës;
2. Pasuar zhvillimin e viseve rurale brenda territorit të Komunës së Pejës dhe në tërë Kosovën;
3. Bashkëpunuar me organizatat tjera që janë aktive në fushën e zhvillimit rural;
4. Vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie me organet përkatëse qeveritare;
5. Vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie me organizata të ngjashme në rajon dhe më gjerë;
6. Promovuar dhe krijuar bashkëpunim të ndërsjellë në fushat e interesit të përbashkët në fushën e zhvillimit rural;
7. Siguruar përkrahje profesionale anëtarëve të vet.

3.2 Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në to, aktivitetet e poshtëshënuara:

1. Rritjen e nivelit profesional dhe teknik të diturisë së anëtarëve të saj;
2. Sigurimin e mbështetjes së informatave relevante në fushën e zhvillimit rural;
3. Planifikimin dhe përpilimin e projekteve dhe programeve në dobi të anëtarëve të saj;
4. Planifikimin dhe organizimin e programeve arsimore dhe informative në Komunën e Pejës, në Kosovë dhe jashtë Kosovës;
5. Prodhimin e materialit profesional në përputhje me objektivat e shoqatës;
6. Bashkëpunimin me të gjitha GLV-te tjera të themeluara në Kosovë dhe jashtë si dhe me Asociacionin e Komunave të Kosovës brenda kornizës së rrjeteve formale dhe/ose joformale;
7. Bashkëpunimin me cilëndo organizatë publike dhe private për të menaxhuar më mirë zhvillimin e viseve rurale në Kosovë;
8. Ndërmarrjen e çfarëdo veprimi tjetër relevant që mund të përmirëson zhvillimin e viseve rurale në territorin e komunës së Pejës.

Neni 4 – Anëtarësimi

4.1 Anëtarësimi në organizatë është i hapur për cdo person pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin, seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike.

4.2 Kuvendi i anëtarëve do të vendosë nëse do të kërkohet pagimi i anëtarësimit nga anëtarët. Mospagesa e anëtarësisë, pas paralajmërimit në të shkruar, do të shërbejë si bazë për përjashtimin e anëtarit nga organizata.

4.3 Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast të:

- a) moskryerjes së pagesës brenda dy muajve pas vendimit të Kuvendit të Anëtarëve për të pranuar aplikacionin e tij/saj. Të gjitha të drejtat dhe privilegjet e tij/saj do të ndërpriten.

STATUTI I GRUPIT LOKAL TË VEPRIMIT "AGRO-TURIZMI" PEJË

- b) Një anëtar shoqate mund të përjashtohet nëse 2/3 e Kuvendit votojnë në favor të vendimit. Vendimi mbi përjashtimin do të ndërmerret në rast të shkeljes së statutit të shoqatës si dhe nëse është në interes të shoqatës që të përjashtojë anëtarin. Nëse kërkohet, anëtarit të përjashtuar do t'i jepet një vërejtje prej 10 ditësh që të ketë kohë ta mbrojë vetën.

Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet.

4.4 Përfundimet ose suspendimet e anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendosen **me shumicë të anëtarëve prezent.**

Neni 5 – Kuvendi i Anëtarëve

5.1 Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.

5.2 Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës.

5.3 Përpos kompetencave që ka Kuvendi i Anëtarëve sipas statutit, ai gjithashtu ka edhe këto kompetenca:

- t'i zgjedhë anëtarët e kryesise (kryetarin, nenkryetarin e pare-sekretarin dhe nenkryetarin e dyte-arkatarin),
- miratojë raportin vjetor i cili duhet përgatitur nga Kryesia e Shoqates.

5.4 Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në Bordin e Drejtorëve ose ndonjë organ tjetër ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij.

Neni 6 – Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

6.1 Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku **dy herë në vit** në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku do të vlerësojë dhe aprovojë mjetet, obligimet, shpenzimet e të hyrave dhe programet për vitet e ardhshme.

6.2 Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga Bordi i drejtorëve. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Sekretarit i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat të shpjeguara në paragrafin 6.3.

6.3 Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku (shtatë) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

6.4 Për mbajtjen e mbledhjes më së paku është e nevojshme pjesëmarrja e 50% + 1 e anëtarëve. Nëse ky minimum (kuorumi) nuk arrihet takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.

6.5 Secili anëtarë i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.

6.6 Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.

6.7 Secili anëtarë i Kuvendit të Anëtarëve mund të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 7 – Bordi i Drejtorëve

STATUTI I GRUPIT LOKAL TË VEPRIMIT "AGRO-TURIZMI" PEJË

7.1 Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Drejtorëve duhet të jetë përgjegjës për kontrollin dhe udhëheqjen e çështjeve dhe pasurisë së organizatës. Bordi i Drejtorëve duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

7.2 Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi i Drejtorëve do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca:

- të përfaqësojë organizatën dhe të veprojë në emër të organizatës
- të lidh organizatën në ndonjë marrveshje me nënshkrimin e dy drejtorëve
- të emëroj dhe të zgjedh përfaqësues
- t'i përcaktoj kompetencat dhe detyrat e çdo përfaqësuesi

7.3 Bordi i Drejtorëve zgjidhet nga anëtarët e organizatës. Ata do të zgjedhen individualisht nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm.

Drejtori zgjedhet me kohëzgjatje prej 1 viti dhe do të ushtrojë detyrën deri në zgjedhjen e drejtorit të ri. Mandati (kotrata) e punës mund të pushoj në rast vdekje, dorëheqje ose shkarkim nga detyra.

7.4 Bordi i drejtorëve do të ketë të paktën (3 anëtarë): Kryetarin, Sekretarin dhe Arkatarin.

7.5 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve **mund** të zgjedhen për mandate të njëpasnjeshme.

7.6 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me votat e MPV-së dhe MPJ-së të Kuvendit të Anëtarëve.

7.7 Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit të Bordit të Drejtorëve, Kuvendi i Anëtarëve duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur.

7.8 vendimet në Bordin e Drejtorëve merren me shumicë.

7.9 Bordi i Drejtorëve mund të vendosë t' drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.

7.10 Kurfarë pagese ose kompenzimi nuk duhet t'u bëhet drejtorëve pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa e kompenzimit është e arsyeshme dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.

7.11 Secili anëtarë i Bordit të Drejtorëve mund të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 8 – Zyrtarët dhe Nënpunësit

8.1 Në rast nevojë Bordi i Drejtorëve do të emërojë Zyrtarë ose të pranojë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Kohëzgjatja e punësimit të tyre duhet të caktohet nga Bordi i Drejtorëve, i cili duhet të informojë Kuvendin e Anëtarëve për emërimet e tilla.

8.2 Zyrtarët duhet të punësohen përmes marrëveshjes së shkruar e cila detalizon të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për organizatë.

Neni 9 – Shpërbërja e organizatës

9.1 Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve. 9.2 Kur të vendoset për shpërbërjen e organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e organizatës. Shoqata (t) ose fondacioni (et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njejta ose të ngjajshme sikurse organizata.

STATUTI I GRUPIT LOKAL TË VEPRIMIT "AGRO-TURIZMI" PEJË

Neni 10 – Ndryshimet e statutit

10.1 Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave të shumicës së Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 11 – Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

11.1 Bordi i Drejtorëve dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.

11.2 Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

Ky statut është aprovuar në Pejë

Më 09/03/09

Nga themeluesit e organizatës

Mehdi Mulaj _____

Sebahate Qorkadiu _____

Pakize Kastrati _____